



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: *01B-101*
Datë: *11.09.2020*

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 6/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e dt. 06.06.2020 dhe nenit 4 të Rregullores (QRK) – nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) – nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dt. 16.06.2020, nxjerr:

V E N D I M

Për fillimin e mësimin në vitin e ri shkollor 2020/2021 në kushte pandemie

1. Fillimi i vitit të ri shkollor 2020-2021 në kushte të pandemisë Covid – 19, do të organizohet në dy faza:

1.1. Faza e parë fillon me datën 14 shtator 2020. Me këtë datë mësimin e fillojnë të gjithë fëmijët e klasës parafillore dhe nxënësit e klasave 1, 2, 3, 6, 10 në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës. Klasat 4 dhe 5 vijnë në mësimin në shkollë (Sipas Skenarit A) ose si mësim i kombinuar (Skenari B mësim në distancë dhe mësim online), varësisht nga kapaciteti i shkollës, në përputhje me vlerësimin e task forcës së DKA-së dhe të institucioneve arsimore.

1.2. Faza e dytë fillon me 21 shtator 2020. Me këtë datë mësimin e fillojnë nxënësit e klasave 7, 8, 9 të arsimit të mesëm të ulët dhe të klasave 11 dhe 12 të arsimit të mesëm të lartë. Forma e mësimin për këto klasa është e kombinuar: nxënësit e vijnë në mësimin dy ditë në javë në objekte shkollore dhe tri ditë në formë të mësimin online dhe në distancë ose një organizim tjetër sipas vlerësimin të menaxhmentit të shkollës.

2. Task forca në nivel të DKA-së dhe task forca në nivel shkollë (e themeluar sipas pikës 6 të këtij vendimi) sigurojnë që institucionet edukative e arsimore kanë krijuar të gjitha kushtet për fillimin e vitit shkollor dhe për zhvillimin e mësimin sipas udhëzuesit të përgjithshëm të MASH, rekomandimeve të MSH dhe IKSHPK, dhe në bazë të vlerësimin të situatës vendosin për veprimet e mëtutjeshme.

3. Nëse task forca komunale vlerëson se një shkollë / institucion parashkollor nuk është e gatshme plotësisht për fillimin dhe zhvillimin e mësimi, atëherë kjo task forcë është e obliguar që të vendosë për zhvillimin e mësimi online derisa të krijohen kushtet për mësim të sigurtë për të gjithë pjesëmarrësit në atë institucion edukativ e arsimor.
4. Të gjitha autoritetet arsimore e shëndetësore do të bëjnë monitorimin e vazhdueshëm dhe të angazhohen për reagim të përnjëhershëm ndaj situatave lidhur me pandeminë në përputhje me protokollin e reagimit të MASH.
5. Me rastin e fillimit të vitit shkollor, ora e parë do t'i kushtohet informimit dhe vetësjesimit të nxënësve lidhur me pandeminë Covid – 19. Në javët në vijim, së paku një orë në javë do t'i kushtohet informimit të nxënësve për zhvillimet më të reja për pandeminë dhe për përgjegjësitë e nxënësve në luftimin e saj.
6. Në nivel të Drejtorive Komunale të Arsimit, duhet të themelohet task-forca komunale (sipas udhëzimeve të Udhëzuesit të përgjithshëm të MASH) për përcjelljen e gjendjes dhe reagimin ndaj pandemisë Covid-19 në fushën e arsimit.
7. Secili institucion edukativ e arsimor, është i obliguar të ketë task forcën që të përcjellë gjendjen e pandemisë dhe të ndërmer masat e duhura në përputhje me udhëzimet përkatëse të MASH, MSH, IKSHPK.
8. Gjatë tërë procesit mësimor, duhet mbajtur maska, të ruhet distanca dhe të bëhet pastrimi i duarve sipas rregullave për fëmijët/nxënësit dhe të gjithë personat e përfshirë në procesin mësimor, në përputhje me udhëzuesit e MSH, IKSHPK dhe të MASH.
9. Vlerësimi i situatës epidemiologjike në institucionet shkollore do të bëhet në mënyrë të vazhdueshme nga task forca e shkollës së paku një herë në dy javë.
10. Prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve / nxënësve, obligohen të respektojnë të gjitha udhëzimet e MSH / IKSHPK, për të shmangur grumbullimin e më shumë personave në një hapësirë të ngushtë, në përputhje me Deklaratën e Përkushtimit të Prindit / Kujdestarit të fëmijës.
11. MASH dhe Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për Arsimim të të Rriturve (AAPARR), sigurohen që lëndët / modulet profesionale dhe puna praktike në shkollat profesionale, të organizohet në objektet shkollore ose në ndërmarrje.
12. Shkolla / DKA, përkatësisht MASH / AAPARR (për arsimin profesional), vlerësojnë mundësitë hapësinore për akomodimin e nxënësve në shkollë, duke respektuar kriteret e IKSHPK / MSH dhe vendosin për skenarin e fillimit të vitit shkollor.
13. Në paragrafin 1 dhe 2 të këtij Vendimi: përjashtimisht, në institucionet arsimore publike dhe private që plotësojnë kriteret hapësinore dhe të tjera sipas udhëzuesit të përgjithshëm për organizimin e mësimi në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID 19 – mund të organizojnë mësimin në shkolla (sipas skenarit A të MASH), duke iu përmbajtur në mënyrë strikte kushteve të vëna nga IKSHPK / MSH dhe MASH.

14. Fëmijët / nxënësit me nevoja të veçanta në Qendrat Burimore zhvillojnë mësimin e kombinuar, dy ditë në Qendrat Burimore dhe tri ditë në shtëpi. Nxënësit e Qendrave Burimore me konvikte mësimin e vijnë në distancë dhe online.

15. Çerdhet dhe kopshtet vazhdojnë punën në përputhje me Protokollin për masat lehtësuese për rifillimin e punës në institucionet parashkollore në Kosovë, Udhëzuesin e përgjithshëm të MASH dhe udhëzimet e MSH / IKSHPK.

16. Përgjegjës për zbatimin e masave të këtij Vendimi janë menaxhmenti i shkollave dhe institucioneve edukative e arsimore, DKA-të dhe task – forca e nivelit përkatës.

17. Përgjegjësit duhet t'i kushtojnë vëmendje në veçanti shmangies së grumbullimit të tepruar të prindërve / nxënësve në oborret e shkollave / institucioneve parashkollore.

18. Zbatimi i masave do të monitorohet nga SIA, DKA-të, inspektoratet e mekanizmat tjerë shtetërorë.

19. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë dhe nevojës për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021, në kohë pandemie, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. DKA-ve;
2. Kabinetit të Ministrit/MASH;
3. Zyrës së SP/MASH;
4. DAP/MASH;
5. Arkivit/MASH.

